REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

**Nr. 223, datë 26.4.2018**

**PËR**

**NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "D", të titulluar "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", shtohet kompania e renditur në shkronjën "a", sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e

konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**SENIDA MESI**

MINISTRI PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

DITMIR BUSHATI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

ARTEMIS DRALO

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË (LISTA E OKB-së)

**A. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA**

**a)** Lista e shtuar **"Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida"**;

1. KHATIBA IMAM AL-BUKHARI (KIB)

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

NR.PROT. 1631/1
DATË 26 · 4 · 2018

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT
BANKËS SË SHQIPËRISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**